

Të startohet me shoqatë – shënime të plota

Idé e Shoqatës

Ju jeni disa persona që keni një interes të përbashkët dhe që dëshironi ta ushtroni veprimtarinë në mënyrë krejt ideale për ta ushtruar veprimtarinë në baza vullnetare. Veprimtaria kushton para dhe ju keni nevojë për një arkë të përbashkët për idén e shoqatës së juaj. Një organizim demokratik rreth arkës është pikërisht – forma e shoqatës.

Statuti

Të punohet bashkërisht një propozim i statutit. Këtu shkruan se si është e ndërtuar shoqata. Në të ardhmen, një kryesi do të mund t'í lexojë statutet dhe do të dijë saktësisht se si duhet të menaxhohet shoqata.

Emri shoqatës, data kur u miratuan statutet dhe eventualisht kur u ripunuan është mirë që të shkruhen në statut.

Mbledhja për themelimin

Lista pjesëmarrësve, përshkrimi i synimeve dhe qëllimeve të shoqatës, vendimi për statutin, do të përfshihen në procesverbalin e themelimit.

Mbledhja e konstituimit

Mbledhja e parë e kryesisë. Procesverbali i kësaj mbledhjeje përshkruan kush çka bën në kryesi. Si është konstituuar kryesia, ndërtimi i saj. Ajo zakonisht është një mbledhje e shkurtër dhe mbahet menjëherë pas mbledhjes së themelimit.

Statuti, procesverbali i mbledhjes së themelimit dhe procesverbali i konstituimit

TANI JU JENI NJË SHOQTË! Ju tani i keni tri dokumente. Procesverbalet janë të vërtetuara dhe të nënshkuara. Kjo është dëshmi se ju keni startuar një shoqatë.

Aplikimi për regjistrim në Administratën e tatimit

Të dorëzohet formulari i aplikimit me këto tri dokumente, për ta regjistruar shoqatën dhe që të merret një *numër organizativ*.

Aplikimi për konto të shoqatës në bankë

Bisedoni me bankën dhe merrni me vete dokumentet e juaja duke përfshirë edhe dokumentin me numrin e juaj organizativ.

Të regjistrohet shoqata në Unionin e juaj kombëtar

Nëse ju doni dhe keni mundësi që t'í takoni ndokujt.

Aplikoni për regjistrin komunal të shoqatave në Këshillin për kulturë dhe kohë të lirë

Ju mund të gjeni formularin e aplikimit nën Më shumë informacione (djathtas) . Si një shoqatë e pranuar në regjistër, ju mund t'í rezervoni objektet komunale me një çmim më të ulët në Kulturë dhe kohë të lirë.

Është shumë e rëndësishme që përfaqësuesi i shoqatës të ketë njohuri themelore juridike për shoqatat! Është gjithashtu një përparësi e madhe kur më shumë anëtarë të Shoqatës të kenë këso njohurish dhe puna vullnetare nuk do t'í konsumojë shumë kohë në qoftë se ka shumë të cilët i ndajnë detyrat.

Ne kemi përvoja të mira për atë që kur themelohet një shoqatë e re dhe është anëtar në një union studjues, atëherë ata në regjinë e tyre bëjnë trajnimin se si funksionon një shoqatë. Të dhënat kontaktuese me unionin studjues i gjeni këtu.